

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
Nr.01-060/01-24623/22 datë:23.08.2022



Npi – 01/264 datë: 31.08.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 31.08.2022 është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES SË -VIII- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES**  
E mbajtur më: 31.08.2022, (e merkurë) në ora 9.<sup>00</sup> h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: Rrahman Jakupi, Përparim Ramusa, Lumni Amrushi, Besartë Musliu-Spahija, Adem Ramadani, Hasan Avdyli, Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, Adelina Beqaj, Besnik Seferi, Gëzim Haxhiu, Reshat Mujota, Asllan Beqaj, Shkurte Mustafa, Sanije Sadiki, (Heroina Selmani on-line), Rrezartë Ramadani, Muhamet Ademaj dhe Rexhep Gashi.

Në mbledhje përvëç anëtarëve të Kuverndit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtoret, Nga ZKF-ja z.Bujar Ferati dhe znj.Kimete Ukaj; Nga Zyra për Informim, z.Gazmend Ademaj, z.Shpëtim Gashi; Nga njësiti për të drejtat e njeriut, z.Reshat Gashi, Nga OJQ “YAHР” z.Bekim Krasniqi, dhe z.Shqiprim Hyseni, praktikant.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstataj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet më 30.06.2022 dhe 07.07.2022,
2. Pyetje - Përgjigje,
3. Shqyrtimi i Listës së Kërkesave Npi-01/223,
4. Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025,
5. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31dhjetor 2021, nga Zyra Kombëtare e auditorit (ZKA),
6. Raporti Vjetor nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJB),
7. Zgjedhja e Komisionit për Ndryshimin e Rregullores për bashkëpunimin e komunës me fshatrat dhe lagjet urbane Npi – 01/89 datë: 27.03.2015,
8. Informatë nga DKA për përgatitjet e fillimit te Vtit të ri shkollor,
9. Propozim-Vendim për emërtimin e Shkollës Profesionale sipas Vendimit të MASHT-it Nr.2-3726 dt.28.08.2019 “Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional”.

**10. Propozim për ndryshimin e nenet 3.5 të Rregullores së Punës së Kuvendit Npi-01-114 të datës 26.4.2019. (Pikë shtesë, në mbledhje)**

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimi për rendin e ditës.

**z.Reshat Mujota:** Përshëndetje, sa i përket rendit të ditës unë po pajtohem me rendin e ditës, por dua të marr sqarim pak më shumë, unë i kam parë rekomandimet, ku në rekomandime hiqen disa kërkesa, e nëse kalon rendi ditës kështu nuk është mirë, ose duhet të hjekën lista kërkesave nga rendi ditës, apo kur të votohet rendi ditës të trajtohen gjitha këto kërkesa. Edhe jam për mu shqyrtuar të gjitha kërkesat, pra nëse votohet kështu rendi ditës duhet ta kemi të qartë se duhet të shqyrtohen të gjitha kërkesat e qytetarëve.

**z.Rexhep Gashi:** Përshëndetje, në parim edhe unë jam qe këtë rend të ditës ta kalojmë, por kërkoj një pikë shtesë të futet në rendin e ditës, pika shtesë është kërkessa ime të formohet një komision për emërtimin rrugëve duke marr parasysh kërkesat e shumta të qytetarëve. Disa vite një Komision i tillë e ka krye këtë punë, po tani janë rritur numri banorëve e njëkohësisht është rritur edhe numri i rrugicave e lagjeve që duhet emërtuar, të cilat kërkojnë emërtim për shkak të adresës që çdo qytetar duhet ta ketë. **Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Zotëri Mujota ta jap një sqarim te rekomandimi juaj, arsyja që të shtyhen gjitha kërkesat është se kemi me e themeluar një Komision gjithëpërfshirës, ku disa nga kërkesat janë më të ndjeshme, dhe duhet me bërë më të gjerë Komisionin me pas edhe anëtarë të Kuvendit por edhe shoqërisë civile, por edhe nga Organizatat e Dala nga Lufta, janë edhe disa kërkesa aty që kemi thënë përveç njërsë që duhet të diskutohet të tjerat të shtyhen për shkak që tani Komisioni që do ta formojmë do ti trajtoj të gjitha. Ju nëse jeni te pajtimit që ne deri sa ta themelojmë Komisionin, e që po besoj në seancën e ardhshme emrat nga Ekzekutivi në bashkëpunim me Kuvendin, do të konsultohemi edhe me shefat e grupeve parlamentare dhe do ta bëjmë Komisionin, ku ne seancën e radhës do ta votojmë Komisionin që të merret me këtë çështje. Nëse jeni të pajtimit vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës, por nëse nuk jeni, edhe mundemi ta heqim këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Përparim Ramusa;** Përshëndetje, fillimisht e përgëzojë Kryetarin për zgjedhjen e Nënkyetarit, në emër të grupit Asamblistëve të Partisë Demokratike të Kosovës, pajtohem me këtë rend dite por me fut edhe një pikë shtesë, pika shtesë që ne si grup e propozojmë është ndryshimi i rregullores së punës të Kuvendit, siç e dini ne para dy viteve ne e kemi ndryshuar rregulloren e punës së Kuvendit për shkaqe Pandemie, dhe kemi qenë të izoluar, ku disa këshilltarë të Komunës për shkaqe të Kovidit nuk kanë mundur të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit të jenë prezent fizikisht në mbledhje, tani mendojë që jemi në tjera rrëthana, në tjera kushte, propozojë që të futet ne rend të ditës ndryshimi i rregullores së punës së Kuvendit, konkretisht që çdo këshilltar i Komunës të jetë i detyruar të marr pjesë fizikisht në mbledhjet e Kuvendit.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Për këtë pjesë, pajtohem me ty por problemi është që duhet paraprakisht me kanë Kuvendi i përgatitur edhe që me zgjedh një komision që të punojë në ndryshimin e rregullores. Ndoshta mos është sot me marr këtë hap mos është i ngutshëm, se edhe ashtu nuk mundemi sot si Kuvend me bërë një Komision të tillë.

**z.Përparim Ramusa;** Unë po propozojë me futur ne rendin e ditës, procedurat ligjore të Kuvendit jemi mi zbatuar, nëse është patjetër me formuar Komisionin e formojmë, nuk jemi ne me dal jashtë rregulloreve e jashtë ligjeve në fuqi.

**z.Reshat Mujota;** Dua të kthehem në fillim te pyetjet që i bëra, te kërkesat, secila kërkesë i ka specifikat e veta, nuk kemi kërkesë që për atë kërkesë duhet të formohet Komision, këta qytetarë na kanë zgjedhur mi realizuar kërkesat e tyre edhe me ju bërë zgjidhje, për ata edhe është formuar ky Kuvend. Kemi kërkesa prej vitit 2019 nuk po më pëlqen mënyra vetëm duke i shtyrë këto kërkesa, ju duhet të jeni më të saktë, nëse arrin kërkesa ju duhet me refuzuar ose me miratuar sa është në sekretari, merreni përgjegjësin si Kryesues edhe Kryetari. Ju këto kërkesa ju njëherë i adresoni për Kuvend, mandej nxirni rekomandime me bërë shtyrjen e kërkesave, mua nuk po më duket që është shumë etike kjo, shumë më mirë është ju me refuzuar në vendin e duhur kërkesën, kur te vjen në Kuvend secila kërkesë duhet që shqyrtohet prej secilit asamblist edhe të diskutohet për te, për qeta edhe na kanë votuar

e na kanë sjellë këtu për problemet e tyre. Kërkojë që këto kërkesa mu shqyrtuar në Kuvend, te ato çka janë për komisione e formojmë Komisionin, Komisionet kur të formohen ky Kuvend ka me marr vendim, nuk e po e shohë ë arsyeshme mi anashkaluar kërkesat. Edhe propozimin për ndryshimin e rregullores së punës të Kuvendit e përkrahu edhe unë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Te propozimi me ndryshuar rregulloren e punës të Kuvendit po pajtohem edhe unë, sepse jam që te gjithë asamblistët të janë në sallë fizikisht, është edhe dëshira ime, jo të lidhen on-line, po për derisa OSH-ë nuk e ka shpall Pandeminë Kovid si të mbyllur mos po ngutemi që ne ta ndryshojmë rregulloren e punës së Kuvendit nëse nesër dikush është i infektuar me Kovid, unë e kam pasur rastin 10 ditë kam qenë i infektuar me Kovid, tani nuk jam më kam dal negativë, nëse ish kanë seanca në këtë kohë nuk ish kanë mundësia me marrë pjesë në seancë. Sa i përket kërkesave zotëri Mujota ne kemi mbajtur një takim, kërkesat me të vërtetë po arrijnë ndonjëherë në adresë jo të duhur, në vend që ti drejtohet kërkesa shërbimeve publike, i drejtohet Kuvendit, kjo është edhe brengë ime, kërkesa njëherë të shkojë në shërbime publike pastaj nëse nuk gjen zgjidhje, drejtori ta sjellë kërkesën në Kuvend me rekomandim që të votohet, ata po i drejtohen direkt Kuvendit, unë mendojë që është gabim. Për këtë dhe shumë arsyje tjera potencova edhe me herët që ta bëjmë një zgjidhje përfundimtare lidhur me këto kërkesa, edhe për ato për emërtimin e objekteve, e mandej kërkesat kanë me arritur me rekomandime. Sa i përket rregullores së punës së Kuvendit, zotëri Ramusa mos po e bëjmë një hap të ngutshëm, që nëse nesër na del dikush me kovid mos me mujt me marr pjesë në seancë.

**z.Besnik Seferi:** Përvendetje, sa i për ketë rendit të ditës pajtohem plotësisht. Meqenëse u diskutua çështja e kërkesave, po ashtu edhe propozimet që erdhën nga kolegët, mendoj që gjithë ti bashkëngjitëm një propozimi të tillë, edhe pse edhe unë mendojë që nuk është koha për këtë, pasi që kemi mundësi gjithsecili të dalim pozitiv me kovid, kjo e pamundëson ndoshta sot ne të marrim një vendim të tillë sa i përket ndryshimit të rregullores së punës të Kuvendit, me qenë se ne kemi qenë kundër, që nuk kishte me qen aktiv nëse marrim pjesë on-line, te kërkesat, mendoj që kanë ardhur të karaktereve të ndryshme, drejtorit duhet të qartësojnë kërkesat, mendoj që duhet të formohen një ose dy Komisione, njërin për emërtimin e objekteve publike, dhe një Komision për kërkesat tjera, kisha këruar nga Kryetari Aliu që në seancat e ardhshme të formohen këto Komisione e të bëjnë mandej punën e tyre në shqyrtimin gjitha kërkesave.

**z.Përparim Ramusa;** Unë kërkova që të futet në rend të ditës ky propozim i jonë, ta diskutojmë. Nëse ju me të vërtet na bindni që është e pa rëndësishme mu ndryshuar rregullorja e punës së Kuvendit edhe na vet e votojmë kundër, ta futim si rend të ditës të diskutojmë. Unë personalisht mendojë që dallojnë rrëthanat që kanë qenë para dy viteve dhe tani kur po flasim, tu kisha lut hedhe në votim, nëse i merr votat e asamblistëve, nëse jo vazhdojmë me pikat e tjera.

**Kryetari z.Qemajl Aliu;** Përvendetje, dua me ju uruar për një sesion vjeshtor të suksesshëm, shpresoj që këto pushime kanë me shërbye për të gjithë ne, edhe për të reflektuar por edhe për të kuptuar përgjegjësit e shumta që kemi ndaj Komunës, ndaj bashkëvendasve tonë nga të cilët kemi marr besimin secili nga ne me votë. Po shpresoj që sesioni vjeshtor do të jetë me kooperativë më bashkëpunues dhe do të shtyjmë përparrë ligje e vendime edhe projekte bashkërisht, unanimisht, që ato çka janë në të mirë të interesit të përbashkët të qytetarëve të Komunës së Shtimes. Sa i përket kërkesave, u diskutuar nga disa asamblistë, është e vërtet që adresimi i kërkesave ndoshta edhe në mungesë të stafit gjatë ditëve të pushimeve nuk ka qenë i koordinuar mirë, tash e tuje do të mundohemi që kërkesat të adresohen në adresën e duhur sepse, qytetarët munden të mos e dinë adresën e saktë, po ne duhet ti bëjmë një orientim të saktë, dhe duhet të shkojnë në adresën e duhur, në mënyrë që qytetarët të marrin përgjigjen e duhur, shumica e këtyre kërkesave janë që i përkasin ekzekutivit. Sa i përket kërkesave specifike siç kemi folur dhe jemi marr vesh ne slumë shpejtë do ta formojmë Komisionin bashkërisht do të ulemi të bissedojmë me përfaqësuesit e grupeve të asamblistëve, por edhe shoqërisë civile, që ta formojmë një grup gjithëpërfshirës i cili do të mirët me emërtimin e institucioneve, ku prej shumë viteve janë të pa emërtuara, ne do të formojmë një komision të denjë që këto institucione ti marrin emërtimet e figurave ose ngjarjeve apo momenteve historike edhe të qytetit dhe të kombit. Unë ju premtojë që shumë shpejtë, për mos me than që në seancën e ardhshme. Sa i përket ndryshimit të rregullores që u kërkua nga

asamblisti Ramusa, nëse standardi për ndryshim ka qenë Pandemia, këtë situatë e kemi edhe tani, nuk e shohë të nevojshme që të bëjmë ndryshime.

**z.Përparim Ramusa;** Në kohën kur e kemi ndryshuar rregulloren ka qen edhe karantina, por rrrethanat tani kanë ndryshuar.

**z.Rrahman Jakupi;** Përhëndetje, dua me u lidh me propozimin Përparimit ne si grup po e kërkojmë ndryshimin rregullore, konkretisht pikën 3.5, pra që ti mundësohet prezenca online vetëm ati që është i infektuar me Kovid.

**z.Reshat Mujota;** Kryetar Aliu në listën e kërkesave mundën me qen vetëm dy kërkesa që nuk i adresohen Kuvendit, tjerat gjitha janë që duhet të diskutohen në Kuvend, ti mi citon cila zgjidhet pa ardhur në Kuvend, këto janë kërkesa që janë të bazuara dhe të drejtuara Kuvendit. Ti si Kryesues nëse nuk ke qenë i gatshëm me bërë zgjidhjen e këtyre kërkesave ti u deshtë mi refuzuar në sekretari, mos mi sjellë fare në Kuvend. Ka kërkesa prej vitit 2019.

\* **Kuvendi i Komunës, me 9 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”** nuk e miratoi rendin e ditës.

**z.Reshat Mujota;** Nuk e kuptova votimin.

**znj.Adelina Beqaj;** Përhëndetje, po lidhem me Reshatin, në votim është edhe pika 3 Shqyrtimi i kërkesave. Kurkush nuk po thotë me hekë.

**z.Lulzim Muaharremi, Zyrtar Ligjor;** Përhëndetje, te ndryshimi i pikave mund të bëhet vetëm një pikë, dhe që ajo pikë të jetë urgjente dhe me rëndësi publike.

**znj.Adelina Beqaj:** nuk po me duket e nevojshme me diskutuar për rendin e ditës kaq gjatë. Mundemi me be një pauzë.

**z.Lumni Amrushi;** Përhëndetje, po futemi në një mjegulli, zyrtari ligjor është me shikuar edhe rregulloren e punës së Kuvendit. Janë propozimet, e hedhë në votim të parin, e pastaj të dytin.

**z.Sanie Sadiku;** Nuk është hera e parë që në këtë sallë ka tendenca me krijuar mjegullina.

**z.Lulzim Muaharremi, Zyrtar Ligjor;** Asamblisti Amrushi e potencoj që kemi edhe rregullore këtu. Duhet ta dini edhe ju të gjithë se ekziston edhe hierarkia e akteve normative, akti më i lartë është Kushtetuta, pastaj vinë ligjet e mandej vinë rregulloret, pas rregulloreve vjen udhëzimi administrativ. Në qoftë se udhëzimi administrativ është në kundërshtim me rregulloren atëherë rregullorja nuk zbatohet, nëse rregullorja është në kundërshtim me ndonjë ligj nuk zbatohet.

**z.Lumni Amrushi;** Te pjesa e rregullores nëse është në kundërshtim me ligjin nuk e ndryshojmë, e nëse nuk është në kundërshtim me ligjin ta ndryshojmë rregulloren e punës së Kuvendit.

**z.Përparim Ramusa;** Zyrtari ligjor nuk është këtu me na mbajtur fjalim politik por është me interpretuar nëse i kërkohet diçka, si po e paragjykon a e ndryshojmë ne rregulloren e punës së Kuvendit a jo. Unë po kërkojë me fut në rend të ditës, nëse është jashtëligjore nuk e ndryshojë as unë, kështu që hidhe në votim propozimin, nuk e di që deri sot që ka ndodh një propozim i këshilltarit të mos hidhët në votim, a ja qëllojmë a nuk ja qëllojmë është qytetari me vlerësuar, këtë punë. Tu kisha lutur Kryesues hidhe ne votim, nëse nuk kalon vazhdojmë, nëse kalon vazhdojmë me pikat shtesë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, me 3 vota “Për” me 15 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim”, nuk miratohet propozimi i Rexhep Gashit.**

\* **Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për” me 9 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, e miratoi propozimin e Përparim Ramusa për ta futë në rendin e ditës pikën shtesë ndryshimin e rregullorës së punës së Kuvendit, konkretisht nenin 3.5.**

\* **Kuvendi i Komunës, me 13 vota “Për” me 4 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim”, miratoi rendin e ditës me propozimin për futjen në rendin e ditës pikën shtesë për Ndryshimin e nenit 3.5 të rregullorës së punës së Kuvendit.**

## Pika 1

### Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet më 30.06.2022 dhe 07.07.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë.

z.Rahman Jakupi; Te procesverbalet ka probleme te kuptimi i drejtshkrimit, kërkoj që procesverbalet të lekturohen sepse, këto publikohen.

z.Lulzim Muaharremi, Zyrtar Ligjor; Deri sot procesverbalet nuk janë lekturuar asnjë herë, ashtu si i kemi thënë fjalët edhe duhet me u shkruar. Prosesverbalet nuk guxon të ndryshohen fjalë ose kuptimi.

z.Rahman Jakupi; Nuk kërkuam sqarime nga Zyrtari ligjor, unë e kam analizuar procesverbalin. Këtu nuk jemi në Gjykatë por në Kuvendin e Komunës së Shtimes,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës, me 13 vota "Për" me 5 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim", miratoi Ekstrakt-Procesverbalet nga mbledhjet më 30.06.2022, dhe 07.07.2022.

## Pika 2

### Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për këtë pikë.

z.Muhamed Ademaj: Përshëndetje, fillimisht e urojë Faruk Beqën për detyrën e Nënkyetarit. Kam një pyetje për DKA-në, a mundeni me na njoftuar lidhur me ndarjen e teksteve shkollore, a ka përfunduar ky proces në të gjitha shkollat tonë? Kam edhe një pyetje për DSHP-në, ka qenë një orar i punës së bizneseve afariste, pse ju ende se keni bërë një orare të tillë?

z.Albana Podvorica: Kamë një pyetje për DKRS-në, viti 2022 njihet si viti i rinisë evropiane, pse po mungojnë aktivitete për të rindjtë, dhe dua ta di cilat aktivitete ju si drejtori i keni paraparë për vitin 2022? Kamë edhe një pyetje për DKRS-në, është një reagim nga klubi i ciklizmit lidhur me ndarjen e subvencioneve për klubet sportive ku sipas tyre ndarja e subvencioneve nuk është bërë sipas suksesit dhe të arriturave nga klubet, përderisa nuk kemi informata nga DKRS-ja apo Komisioni për ndarjen e subvencioneve për të parë se me cilat kritere është bërë ndarja e buxhetit? Dhe pyetja e tretë është për DKA-në, pse nuk është organizuar shkolla verore "Bleta" dhe a mendohet të organizohet viteve të tjera?

z.Reshat Mujota: Kam pyetje për DSHMS-në, sa keni arritur të jeni të furnizuar me barna esenciale në QKMF-ë, dhe qendra tjera familjare, dhe si qëndron furnizimi me vaksina përfundimtare, me vaksinën e tuberkulozit dhe hepatitit, kamë informatë se nuk ka vaksina në QKMF-ë dhe a ka ambient përuajtjen e tyre ? Pyetja e dytë është për DSHP-në, kamë një kritikë sepse pyetjeve që i kamë bërë i kanë dhënë një drejtim tjeter, disave u janë përgjigjur si e kam bërë pyetjen, ndërsa për disa kam pritë reflektim, mirëpo i kemi bërë dy muaj që është zotuar. Shumë shpejtë për disa ambiente ku janë me mbeturina kemi me intervenuar, u bënë dy muaj prej pyetjes që e kamë bërë dhe asnë aktivitet nuk e kamë parë prej kësaj Drejtorie pse?

z.z.Adelina Beqaj: Kam pyetje për Kryetarin z.Qemajl Aliu, pse nuk ka gra më shumë në Ekzekutiv? Pyetja e tjetër për DSHP-në, te Parku i Pishave pse nuk po mirëmbahet? Pyetja e tretë për Kryetarin z.Qemajl Aliu, punësimin me CARITAS e keni quajtur të jashtëligjshme, pse tanë po vazhdon aty po punëson militantë te Vetëvendosjes, a është e jashtëligjshme tanë?

z.Besart Musliu-Spahija: Kam pyetje për DPUKGJ-në, përrugën e fshatit Topill që Kryetari ju ka premtu që do të bëhet, kur do të fillojnë punimet në këtë rrugë? Pyetja e dytë është për DPUKGJ-në, a është përfunduar kanalizimi në Qest, apo kur ka me përfunduar, sepse atje ka disa shtëpi pa kanalizim?

z.Adem Ramadani: Kamë pyetje për DSHP-në, Te rruga "Dëshmorët e Reçakut" a është planifikuar të bëhet: Ndriçimi i rrugës, Trotuari dhe a duhet të vendoset tabela e emërtimit të rrugës pasi, ka kohë që nuk është vendosur?

z.Hamëz Tërshani; Kam pyetje për Kryetarin z.Qemajl Aliu, është vazhdimësi e pyetjes nga mbledhja e kaluar por nuk kam marr përgjigje, kam kërkuar sqarime nga Kryetari lidhur me procesin e Prokurimit (shërbimet e interpretimit dhe përsaqësimit ligjor)? Pyetja e dytë e kam gjithashtu për z.Qemajl Aliu, në bazë të një kërkese të një banori të fshatit Muzeqinë lidhur me Çerdhen që është premtuar në fushatë se do të bëhet funksionalizimi i saj me 1 shator të këtij viti, duke e parë që objekti ka nevojë për disa

intervenime jo të mëdha, pse kjo Çerdhe nuk është funksionalizuar ende? Pjetja tjetër është për DKRS-në, më intereson me ditë lidhur me gjendjen e klubeve sportive në Komunën e Shtimes për sezonin e ardhshëm duke marr parasysh që subvencionet nuk janë realizuar ende?

**z.Lumni Amrushi:** Kamë pyetje për DSHMS-në pse laboratori në punktin në Pjetërshticë nuk është aktivizuar ende, edhe pse jemi në dijeni që pajisjet e laboratorit kanë shkuar në këtë punkt?

**z.Rexhep Gashi:** Kam disa pyetje, pyetja e parë për DPUKGJ-në, kamë vërejtur që te shkolla e mesme te rruga “Isa Boletini”, pastaj te shkolla fillore “Emin Duraku” te rruga “Tahir Sinani” edhe te disa shkolla tjera në komunën tonë janë fshirë zebrat për këmbësorë, duke llogaritur që janë afër shkollave e rreziku është shumë i lartë, çfarë do të ndërmerr drejtoria lidhur me këtë problematikë? Pyetja e tjetër për DSHP-në, lidhur me vendosjen e pasqyrave në këndet e vdekura te rruga “12 Qershori” dhe rruga “Jetë Hasani” ende mungojnë çka do të ndërmerrni ju si drejtori që të vendosen këto? Pyetja e e fundit për DSHP-në, kamë disa foto këtu mundeni me i shkuar si Kuvend në rrugën “Isa Boletini” dhe rrugën “Adem Jashari” gjendjen e trotuareve e cila nuk është e mirë, edhe pse keni premtuar që do ti pastroni trotuaret nga balta dhe ende nuk është bërë, çfarë masa do të merni ju si drejtori?

**z.Rahman Jakupi:** Kamë Pyetje për DKA-në, kam një mesazh në telefon ku një arsimtar i lëndës më ka shkruar: (lexon mesazhin) ai thotë që Drejtori i DKA-së ju ka kërkuar në shkollë listat e Arsimtarëve që janë në grevë, nën kërcënimin se do ua ndalin pagat grevistëve, a ju keni bërë presion të tillë Arsimtarëve?

**z.Përparim Ramusaj:** Pyetja e parë për Kryetarin Qemajl Aliu, pse janë ndalë punimet në rrugën Shtime-Lipjan, edhe kur do të fillojë rregullimi i rrugës Transit, u banën 6 muaj që kur ke premtuar? Pyetja e dytë për Kryetarin Qemajl Aliu, pse nuk po punon lifti në QKMF, si minden mu ngjit ne katin e dyt pacienti që ka probleme me zemër? Pyetja e tjetër për Kryetarin z.Qemajl Aliu, pse mungon insulina, dhe kur do të bëhet furnizimi me këtë medikament shumë të rendësishëm për personat që kanë probleme me diabetin ?Pyetje e fundit për Kryetarin Qemajl Aliu, sipas një rasti konkret, në QKMF në Shtime ka munguar një Pantoprazol, pse ka pasur mungesë të një bari të tillë, mjeku ne QKMF e ka dërguar një Lehonë me pru ne Ferizaj për një Pantoprazol, gjendja në QKMF në Shtime me barna është kaotike, ki vërejtje prej qytetarëve ?

**z.Gëzim Haxhiu:** Kamë një pyetje për DSHP-në, çka ka diçka konkrete që keni ndërmarrë lidhur me trajtimin e qeneve endacak?

**z.Besnik Seferi:** Kamë disa pyetje, gjendja me qenet endacak është shqetësuese ne Komune n e Shtimës, pyes DSHP-në. Çka keni ndërmarrë konkretisht lidhur me trajtimin e qeneve endacak?

Pyetja e dytë për DSHP-në, sa ka qenë numri i kërkesave të qytetarëve lidhur me dëmet e fundit të shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Shtimes?

Pyetja e tretë për DSHP-në, rruga “15 Janari” sa herë që ka vërvshime grumbullohet zhavorri, çka keni ndërmarrë ju si drejtori lidhur me këtë çështje?

Pyetja e katërt për DSHP-në, pse në rrugën “Xhemshir Xhemshiri” mungojnë disa puseta të kanalizimit, këtë pyetje e kam nga një qytetar, i cili si person edhe si biznes është i rrezikuar kur ka te e reshura rrezikohet biznesi edhe prona tina nga mungesë e disa pusetave?

Pyetje e tjetër për DSHP-në, te këta drunjë dekorativ kam vërejtur se nuk janë të mbjella në vij te drejt e prandaj s’po tregon mirë për syrin, pse mbjellja e drunjëve dekorativ nuk është bërë në vijë të drejtë, njashtu edhe vendosja e ulëseve pse nuk është bërë në vende të frekuentuara? Pyetja e fundit për DSHMS-në, vendimi për shtesat prej 100 eurove për nënënat Lehona, a ka filluar ekzekutimi i pagesave desha të dijë?

**Kryetari z.Qemajl Aliu;** faleminderit për pyetjet, sa i për ketë zonjës Beqa, pyetjes për punësimet me CARITAS, CARITAS-in nuk e kemi sjellë ne e kemi gjetur në mesin tuaj, këtë kontratë abuzive për punësimin e shokëve keni me pa që shumë shpejtë ka mu eliminuar. E dyta kuota gjinore çka me be që ne Vetëvendosje nuk kemi fatin me pas kuadrot sikur që ju ka juve PDK-ja, për ndryshe do ta kishim rregulluar, edhe shyqyr që se kemi. Zotri Tërshani është hera e dytë që po e bënë pyetjen për një aktivitet të Prokurimit për një zyrë ligjore, është e vërtetë që ne kemi iniciua një aktivitet prokurimi për të marr konsulentë e një zyre ligjore në mënyrë që krejt kontestet ligjore, lidhur me pronat, lidhur me kontratat,

dhe me gjitha kontestet dhe abuzimet që janë bërë nga ish pushteti, ne duam ti adresojmë aty ku e kanë vendin, dhe nuk e di pse është hera e dytë ose e tret qe pot dhemb , ndoshta e ki mizën ndër kapelë, mos ndoshta ke bërë ndonjë zarar, nëse ke bërë gjera që nuk janë ligjore me të drejt po interesohesh, e nëse nuk ke bërë mos u merakos. Cerdhja në Muzeqinë është e vërtet që është projekt ma që çdo krekës që bëhet nga Komuna Shtimes kur gjemjë hapësira publike apo anekse te shkollave kemi te drejt ta restaurojmë, me rialokim të bugjetit do të ndodh. Rruga Shtime Lipjan, është e vërtet që rruga ka filluar, fondet që ka pas Ministria e Financave ky fond i mirëmbajtjes, ka mbaruar dhe duhet të bëhet një rialokim në këtë fond dhe të vazhdoj, por te jeni të bindur se do të kryhet shumë shpejt deri te rrëth rrrotullimi i Lipjanit bile kam premtim nga Ministri që do të vazhdoj deri te QMI-ja. Transiti e vërtet është një rrugë e trashëguar, nuk është që është bërë qe 8 muaj, e qytetorëve ju kushton shtrenjtë edhe bizneseve, për shkak të procedurave të rishqyrimit të bugjetit nuk kemi arrit me krye, te jeni të bindur se unë do kërkojë nga Ministria e infrastrukturë që ta bëjë këtë shumë shpejt, ju kërkoj falje qytetareve por na mirëkuptojnë edhe ata sepse kjo është plagë e më hershme. Sa i për ketë shërbimeve shëndetësore Përparim e ki një intonacion kur i thuk to ankesa vaji të mbërthen, thua ti që këtu është dit zije ku me dit çfarë hataje ka ndodhur, sikur të kishe qen kaq i zëshëm deri me tanë në raport me një mjekësi që e kemi gjetur të katandisur, por në atë kohë je pajtuar me këtë gjendje, te jemi të sinqertë para qytetareve të komunës e din në çfarë gjendje e kemi gjetur këtë sistem, me çfarë menaxhimi e kemi gjetur, dhe qytetaret e din që ky është vetëm fillimi dhe e din që duhet kohë mu bërë ajo çka është premtuar, e din edhe ata e dini edhe ju që QKMF ja nuk ka funksionuar asnjëherë më mirë deri më tanë, një personel të përgjegjshëm 24 ore në shërbim të qytetarëve, mos krijo situata konfuze, insulina në këtë vit ka qenë me furnizim më të mirë se ne vitet tjera, a ka vend për mu be ma mirë ka edhe qytetarët e Shtimes kanë mi shiju këto të mira shumë shpejt, e për ata që duan me vajtuar vazhdoni vajtoni, deri tanë është bërë maksimumi shenjat e para të përmirësimit janë bërë e do të vazhdojmë tutje.

**z.Kastriot Shabani, Drejtor i DZHE;** Sa i për ketë kontratës për trajtimin qeneve endacak zotimi është marr në muajin e 4 ka shkuar në OSHP, me 28 këtij muaji u nënshkrua edhe kontrata, edhe tanë prej të hënës fillojnë me ato procedurat.

**z.Isa Haxhiu, Drejtor i DSHMS;** Përshëndetje, lidhur me pyetjen e asamblistit Mujota që sa kanë arritur të janë të furnizuara QKMF dhe ambulançet tjera ne kuadër të sajë, mundë të themi se ne nuk jemi të kënaqur, dihet që furnizimi me barna bëhet nga Ministria e Shëndetësisë, dhe një analizë se vetëm 30 përdhënës mbulohet me barna, ndërsa pjesa tjeter mbetet që të kujdesimi ne. Edhe ky furnizim nga Ministria e Shëndetësisë ndonjë herë nuk behet me irregull, ne zakonisht e bëjmë listën e barnave që janë më të domosdoshme më esenciale por ata nuk i përbahen kësaj, p.sh. gjatë kësaj kohe ka munguar furnizimi me glukozë nacl ku dihet që kanë qen më të nevojshme për shkak të pandemisë, por ata nuk na kanë dhënë arsyje, dihet që plani bugjetor ka qen i më hershëm, mund të ketë ndodh siç e tha asamble siti Ramusa, por nuk besoj që për një pantoprazol duhet me dërguar pacientin atje, ku me një sodë të bukës mund të largohen pjesa acidike, lidhur me insulinën do të marrim përgjigje me shkrim dhe do t'ju a prezantojmë. Lidhur me pyetjen e asamblistit Amrushi ne projekt bugjet kemi parapa edhe një person që do të punësohet në këtë laborator, organizatave, për vitin e ardhshëm e sa i përket militanteve nuk kam se unë nuk jam asnjë parti politike, e nëse zotëri Amrushi ka ndonjë militant do të na e prezanton.

**z.Grejtalb Emini, Drejtor i DPUKGJ:** Përshëndetje besoj që mundem me ju përgjigj gjitha pyetjeve, shqetësimi kryesor është te pyetja e Besnikut kemi pasur dy raste të vërshimeve, kemi dal në vend te ngjarjes kemi qenë ngatë qytetareve, nuk kemi pasur vijë bugjetore, nuk kemi gjetur asnje projekt, por besoj që kemi me bere zgjedhje, sa i përket kërkësë se Isuf Hsyenaj nuk kemi asnjë bugjet për momentin për me trajtuar këtë kërkësë edhe i kemi dhënë edhe përgjigje. Lidhur me pyetjen e te kërkesa e banorëve te rruga e fshatit Topill, ajo është rrugë e ministrit, siç çdo rrugë edhe ajo hyn te kontratat problematike sa i përket çmimit por besoj që shumë shpejt do të kryhet edhe ajo rrugë. Te kanalizimi në Qeste, kemi dal ne vend të ngjarjes janë dy mundësi sipas reliefit jemi duke planifikuar me futur në bugjet te vitin 2023 sepse ne këtë vit nuk ka pasur asnjë projekt për këtë problematik. Një pyetje ke te rruga haxhiu, është nënshkrua kontrata që e përfshin edhe ndriçimin, është e planifikuar në dy fazë.

mbete me pa a mundet operatori me përfundua këtë vit por mundem me ju siguruar që kontrata është nënshkruar.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Rregullorja e thotë që pas përgjigjeve të Ekzekutivit nuk ka ma komente as pyetje.

**z.Përparim Ramusaj;** Kryetari na dha përgjigje, e falënderojmë që na dha përgjigje, ka dhanë përgjigje tendencioze, për me tregu unë Kryetari që ajo çka thave nuk është e vërtet.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pas përgjigjeve të Kryetarit nuk ka më replikë, jam shumë i saktë në këtë çka po them, gjene irregulloren lexojeni.

### Pika 3

#### Shqyrtimi i Listës së Kërkesave Npi-01/223

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimi për këtë pikë dhe lexoi rekomandimin e KPF-së.

**z.Rahman Jakupi;** Kryesues ne dimë mirë me lexuar edhe me kuptuar irregulloren, ajo thotë lexoi nenin ku thotë që asamblisti ka 5 minuta për replikë nëse i përmendet emri tina, ku kanë drejt edhe dy minuta shtesë në sqarimin e dytë.

**z.Besnik Seferi;** Përshtendetje po ndërlidhna me diskutimin paraprak, pyetje përgjigje kemi pas edhe me herët por mbas Ekzekutivit nuk ka me diskutime, irregullorja na lejon por për gjera tjera, Kryetari dhe drejtoret munden edhe hiq mes me na dhënë përgjigje, te kjo pik është mirë zotëri Aliu ta iniciojnë formimin e këtij Komisioni qe këto kërkesa të trajtohen e të shqyrtohen.

**z.Rexhep Gashi;** Çdo asamblist e ka drejtën e vet me fol, jemi ardhur në mbledhje por nuk e dimë kur përfundon, nuk jam askujt me ja mohu drejtën, kur keni qen opozitë keni than ndryshe tash kështu, na po kërkojmë te neni 3.5 mu hekë.

**z.Reshat Mujota:** Lidhur me Komisionin duhet me nxjerr ky Kuvend vendim e jo Kryetari me bë propozim se propozimi nuk merret parasysh po vendimi merret parasysh, te kërkesat tregoni që nuk keni guximin mu merr me to e jo gjithë mi shty, unë kam guximin me shqyrtuar çdo kërkesë se votën e kam marr para qytetarit e jam përgjegjës me i shqyrtuar kërkesat e tyre, caktoni Komisionin, ka kërkesa që s'duhet te hyn ne komision, i nderuar Kryetar shiko kërkesat prej vitit 2019 ki kërkesa, tregoni që nuk keni guxim me marr përgjegjësi mi shqyrtuar kërkesat.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ne kemi thënë që do ta bëjmë një Komision i cili do të jetë gjithëpërfshirës, e ta shtyjmë listën e kërkesave, seancën e ardhshme kemi me formuar Komisionin edhe qaj Komision ka mi shqyrtuar kërkesat, edhe ato për emërtimin e rrugëve, barrën mandej e bart Komisioni edhe ekzekutivi, pra mos te mbajmë hapa te ngutshëm që te emëtojmë në mënyrë jo të duhur. Pajtona qe jemi shumë vonë se ka kërkesa prej 2019 ka pas probleme kërkesa të ndjeshme, për ata që janë të ndjeshme ta bëjmë një Komisionin gjithëpërfshirës , edhe tani vazhdojmë me këto kërkesa.

**z.Përparim Ramusaj;** Në emër të grupit parlamentar. Nuk je Kryetar për me ju kërkuar falje qytetarëve por mi realizuar premtimet që ju ke dhënë. Kush je ti me caktuar shokë tu për keqpërdorimet, mos të ne punët e huaja, sepse janë organet. Pika 3 u be katrahurë, propozojë në mbledhjen e radhës të jetë si pikë formimi i Komisionit, kërkesat i kemi analizuar mirë në KPF. Tjerat kërkesa mundemi pa Komision. Propozojë që rruga te Kulla e Lirisë dhe shkronjat e UÇK-së, të futet në bugjet, dhe të futet edhe mirëmbajtja e tyre.

**z.Muhamet Ademaj;** Është mirë që çdo kërkesë ti adresohet Ekzekutivit, me qëllim që të sqarohen më mir. Jemi që kërkesat mu shty për mbledhjen e radhës.

**z.Reshat Mujota:** Le të ndahen kërkesat ato që janë për bugjet le të futën për shqyrtim, sikurse është ajo e Berkim Osmanit.

**Kryetari z.Qemajl Aliu;** Përparimi u kthye në pikën e dytë të rendit të ditë. Kur flet për injekësin duhet me qenë i saktë. Ndërsa kur flet për kërkesat pse duhet me u nda vetëm një kërkesë për me u shqyrtuar, apo vec se është bashkëpertiak. Unë po them se kjo rrugë për të cilën ka bërë kërkesë Avdullah Musliu para disa ditësh është vizituar nga Ministri, kështu që ky projekt është në procedurën projektuese, sepse e meriton një trajtim dinjitoz. Ne si Komunë me bugjetin tonë nuk kemi mundësi që ti a dalim realizimit ashtu si duhet të këtij projekti, kështu që presim se do të kemi një bashkë financim.

Ndërtimin e kësaj rruge e duam të gjithë pa përjashtim. Së shpejti do të kemi edhe dëgjimin publik për bugjet kështu që e stojë edhe Avdullah Musliun dhe të gjithë të tjerët që të kontribuojnë në diskutim lidhur me bugjetin.

**z.Përparim Ramusaj;** Shumë njeri më ka thënë se je gënjeshtar e mashtrues, por tanë po e vërtetojë vetë. Ti ke shkuar ne Tetovë me studiar e në Gjermani dhe nuk ke mundur me gjet vend.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** dha 10 minuta pauzë në ora 11:40h.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Vazhdojë mbledhjen në ora 11:59.

**z.Adem Ramadani;** Avdullahun e kam djalë të agjës. Kryetari tha që është çështje partiake. Ai ka kërkuar me u rregulluar rruga e cila është e nevojshme. Po ashtu ka kërkuar që në këtë rrugë të ndalohet transporti i automjeteve të rënda. Unë mendojë se duhet me u aprovuar.

**z.Rexhep Gashi;** 20 kërkesa janë gjithsejtë, mos të kalojmë në kërkesa si më parë. Unë mendojë se ato kërkesa që janë të një kategorie ti trajtojmë. Mirëpo kërkesat duhet të shqyrtohen secila veç e veç.

**z.Besnik Seferi;** Me shit moral këtu ne Kuvend është shumë keq. Unë jam për atë se far mundësie të kemi ashtu me dhënë përgjigje në kërkesë. Kërkesat duhet të trajtohen nga drejtorit. Edhe komisioni duhet me na e sqaruar gjendjen për secilën kërkesë, mirëpo kur të formohen komisionet. Po shihet këtu që tendenca është që Kuvendi me dal qesharak.

**z.Rexhep Gashi;** nuk kemi rekomandime për kërkesa. Ekzekutivi është dashur me arritur kwtu ne Kuvend më propozime konkrete.

**znj.Adelina Beqaj;** Më herët arsyaja e mos trajtimit të kërkesave ishte se nuk janë formuar ende komitetet, ndërsa tash nuk e kemi asnë rekomandim.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë po e hedhin ë propozim propozimin e Përparim Ramusa.

**z.Reshat Mujota:** A po votohet sipas KPF-së apo sipas propozimit të Parparimit. Unë po deklarohem publikisht se nëse votohet sipas formatit të KPF-së edhe unë e votojë.

**z.Rexhep Gashi;** Unë po kërkojë që të na jep një sqarim drejtori e DPUKGJ-së.

**z.Grejtalb Emini, Drejtor i DPUKGJ;** Rruga deri të Kulla e Lirisë duhet të kushtojë rrëth pesë qind mijë euro, e që për bugjetin tonë është i pa përballueshëm. Kryetari e sqaroi se është në bisedimi me Ministrinë. Sa i për ketë mirëmbajtjes ne mund ta diskutojmë këtu.

**z.Përparim Ramusaj;** Kjo është kërkesa e Avdullah Musliut e jo e Përparimit. Ne jemi për me u futë në qarkoren buxhetore.

**z.Reshat Mujota;** Unë kam kërkuar për me u trajtuar kërkesat. Edhe unë vet jam për aprovimin e kërkesës , e jo për partinë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës, unanimisht vendosi që të shtyhet për shqyrtim, Lista e Kërkesave me numër Npi-01/223 e datës 15.07.2022, përveç kërkesës Nr.01-070/05-24330/22 e datës: 22.08.2022, të z.Avduhall Musliut nga fshati Raçak, për të cilën u vendos që të merret parasysh si propozim për ta futë në listën e projekteve kapitale në Planin Buxhetor të Komunës së Shtimes për 2023-2025.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Dha një orë pauzë për drekë, në ora 12:15. Mbledhjen e vazhdojë në ora 13:30.

#### Pika 4

##### Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** fjalën ja dha Bujar Feratiit.

**z.Bujar Ferati,** zyrtarë kryesor financiar; Përshtëndetje, e keni marr Draft-Raportin Plani Buxhetor 2023-202, e keni marr me kohë dhe e keni lexuar, unë po ju a lexoj në pikat kryesore (shih dokumentin). Në vazhdim lexoi shkurtë sipas Kategorive ekonomike buxhetore. Ka me shkuar në diskutim publik, ju stojë me votuar.

**z.Reshat Mujota;** E kam parë prezantimin planit nuk pe diskutojë, se ka me dalë në diskutim publik, dhe do të marrë pjesë në debat. Në cilat kategori ka ulje të vlerave.

- z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor finansiar;** Buxheti ka ngritje prej 1.22.23 euro. Në krahasim me vitin e kaluar.
- z.Përparim Ramusaj;** Sinqerisht po shoh gabime shumë. Rruga Zborc-Pjetershicë është ë kontraktuar, duhet me u krye ketë vit jo me qenë e planifikuar në vitin e ardhshëm, rruga Godanc - Zborc për vitin 2023 nuk është planifikuar asnjë centë. Qysh mu pajtuar me këtë buxhete.
- z.Muhamed Ademaj;** Faleminderit, ne mendojmë se ky planë duhet të del në diskutim publik me qëllim që ta shohim se qfarë kërkesa kanë qytetarët.
- z.Rexhep Gashi;** Faleminderit, meqenëse do të del në diskutim publik unë po bëjë apel që të gjithë të japid kontributin e tyre. Unë e kamë një kërkesë që kamë përsëritur edhe më herët që të bëhet një ndërtim i një nënkalimi te lagja Sahitovite në Pjetershicë, mendojë se mundë të bëhet me 35 mijë euro. Po ashtu edhe një trotuar në rrugën "Besim Sopa" në fshatin Gjyrkovic.
- z.Besnik Seferi;** Faleminderit, u potencua se është dokument i rëndësishëm, mirëpo ka nevojë për të ndërhyrë në disa gjëra. Meqenëse shkon në diskutim publik unë e presë një debat të mirë sidomos të anëtarëve të KPF-së të cilët duhet me qenë aktiv.
- z.Grejtalb Emini, Drejtor i DPUKGJ;** Dua të sqarojë lidhur me një gabim teknik që duhet të rregullohet sepse janë dy rrugë që lidhen me Zborcin. Sa i përket sallës së sportit nuk mundë ta bëjmë me 40 mijë euro, por nëse flasim për participim ajo është diçka tjetër. Ne kemi vepruar sipas kërkesave dhe nevojave. Ky është pra një planë buxhetor i cili ende nuk është bërë buxhet përfundimtarë.
- z.Lumni Amrushi;** Përshëndetje, ky far gabimi teknik sikur po ju shfajëson juve që dy muaj ka kaluar dhe ende nuk e keni përmirësohet.
- z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor finansiar;** Unë e potencova se ky është një draft buxhet edhe se do të përmirësohet.
- z.Reshat Mujota;** Po e pranojë që bëhen gabime teknike për ata jemi këtu që ti përmirësojmë. Te rruga Zborc-Godanc i Epërm kam paqartesi sepse tash po del në vitin 2023, a u shty apo nuk po mjafton buxheti për këtë ose na tregoni qka është në pyetje?
- z.Grejtalb Emini, Drejtor i DPUKGJ;** Rruga Godanc i Epërm- Zborc ka qenë projekt dy vjeçare 2022-2023.
- Kryetari z.Qemajl Aliu;** Kësaj radhë e kemi buxhetin e Komunës për 1.1 milion euro më shumë se vitin e kaluar, edhe kjo rritje do të shkojë në projekte kapitale në të cilat prioritet do të kenë kërkesat e qytetarëve. Përmes dëgjimeve publike që do ti organizojmë, por edhe duke u bazuar në zotimet tona ashtu qysh kemi ardhur në pushtet do të radhiten edhe projektet kapitale. Buxheti aktual në të cilin jemi duke punuar është buxhet elektoral, këtë e dinë ç'do kush i cili e ka lexuar këtë buxhet. Ju ftojë që të merrni pjessë në dëgjimet publike. Po më vjen keq që disa njerëz e kanë humbur arsyen dhe janë futur në mjerim, me të vërtet për këta më vjen keq, sepse nuk është hera e parë kjo që po marrë ofendime, këtë e bënë vetëm njeriu që ka humbë arsyen.
- z.Përparim Ramusaj;** Gjëja më e rëndë është kur i padituri të shet dituri. Edhe i ligu kur shet trimëri.
- Kryetari z.Qemajl Aliu;** Këto qe i thave sigurisht që i gjykon qytetari. Ndërtimi i argumenteve në baza të gabuara shkencore do ta them unë dhe do ta gjykojnë qytetarët.
- z.Përparim Ramusaj;** Unë jam mjek specialist, e di që ilaçi Pantoprazol e di që nuk ta shpëton jetën, por ka mungesë të tije. Ç'do premtim që e ke dhënë unë kam me të mbajtur përfundimtarë.
- Kryetari z.Qemajl Aliu;** Ju kërkojë falje qytetarëve, nuk bën me ndërtuar kauza të paqena mbi bazën e ilaçit pantoprazol, dhe mos i dramatizo gjérat.
- z.Reshat Mujota;** E kam një lutje te ti Kryesues që ti përbahesh irregullores së punës të Kuvendit për sa i përket pikave të rendit të ditës. Unë po e pyes kryetarin që të na shpjegojë rrugën Godanc i Epërm-Zborc se a ka tjetër buxhet, apo është gabim teknik.
- Kryetari z.Qemajl Aliu;** Ka gabime teknike, por ky është një draft i cili deri në miratim ka mundësi që të përmirësohet, kështu që buxheti përfundimtar do të jetë në rregull. Po ju bëjë me dije se edhe rruga Godanc i Epërm – Zborc edhe ajo Pjetershicë – Zborc edhe rruga Godanc – Gjyrkovic (Hani) do të bëhen sepse janë nevojë e qytetarëve, por edhe është zotim i imi. Vullneti im është që linja

Pjetërshticë – Gjyrkove duhet të përfundojë, për arsy se është nevojë e qytetarëve por edhe vijë që i ka shërbyer qytetarëve gjatë luftës.

z.Reshat Mujota; Drejtori u zotua që projekti Godanc i Epërm - Zborc është në proces dhe duhet të paguhet një pjesë në vitin 2023. Në buxhet nuk janë 10 mijë euro por janë mbi 30 mijë euro.

z.Rrahman Jakupi; E ndijë obligim moral me tregu se duhet me u respektua secili njeri sepse ka dinjitet. Qasja diskriminuese nuk i bën nder askujt. Ne do ti prezantojmë edhe argumentet. Sa i përket buxhetit ne jemi që të shkojë në diskutim publik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

\* Kuvendi Komunës, unanimisht, miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Planin Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2023, përafatë prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra Komunale për Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim, dhe Komitetin për Politikë dhe Financa.

### Pika 5

#### Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31dhjetor 2021, nga Zyra Kombëtare e auditorit (ZKA)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financier; Sa i përket gjetjeve dhe opinionit të auditimit do të sqarojmë në pikat kryesore. Unë po besojë që materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar. Opinion i auditorit është opinion (i pamodifikuar), që është opinion i mirë. Për sa i përket të gjeturave nga auditori ne duhet me hartua planin e veprimit për shqyrtimin e të gjeturave. Nëse ka ndonjë pyetje unë jam i gatshëm të ju përgjigjem.

z.Përparim Ramusaj; Unë e kam dhënë mendimin tim në KPF. Opinion i auditorit është opinion i mirë , për këtë arsy unë nuk kam debat më për këtë pikë.

z.Rexhep Gashi; Ç'do pikë e ka rëndësinë e vetë. Auditori ka gjete dhjetëra të gjetura, nuk është për mos me u diskutua. Te DSHP kemi artikull me dhjetë centë pyetja është çka mundë të bëjmë me dhjetë cent. Ka dallim në mes raportit të auditorit jashtëm dhe atij të brendshëm.

znj.Rrezartë Ramadani; Kemi 15 raste që kanë dy njësi banimi, e këta persona që janë gjetur a ndiqen penalisht a po jo, sepse me ligj është i obliguar vetëm një vendbanim.

z.Muhamed Ademaj; Ne nuk mund ta votojmë këtë raport, por vetëm duhet ta kemi në kuadër të informimit të Kuvendit, dhe mundë të jepim mendimin tonë.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financier; Ky është rapporti me të gjeturat që ai i ka gjete, ne duhet me bë një komision për me analizua vërejtjet dhe me i eliminua. Disa prej të gjeturave veç janë eliminuar. Te pronat ka mundësi që ka gabime teknike. Si gjetje auditori e ka rekomandua, që gjetjet duhet me u trajtuar dhe me u harmonizuar.

znj.Rrezartë Ramadani; Lidhur me zjarrfikësit me sa e di unë Komuna i ka paguar, si është e mundur që Komuna me i paguar e mos me ditë se a kanë punuar ata apo jo?

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financier; Kjo është e mundur mirëpo është e pak e komplikuar dhe meqenëse se ti je në mandatin e parë edhe me e kuptua është pak vështirë. Kjo më shumë është një mos harmonizim i Komunave me agjencinë, mirëpo kjo ka me marrë fund sepse ankesë për këtë kanë të gjitha Komunat.

znj.Rrezartë Ramadani; Te shkolla fillore në Carralevë, (përmendi disa data) Komuna jonë ka paguar 38 mijë euro, ndërsa Ministria ka paguar gjithsej 512 mijë euro, a është ky projekt i përfunduar?

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financier; Përveç mjeteve financiare auditori ka vërejtje edhe për punët në teren. Ne do të dalim me një raport të saktë.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare e ZKF; Pëershëndetje, ndërtimi i shkollës në Carralevë ka qenë projekt i Ministrisë. Për shkak të mos kryerjes së disa punëve nga punë kryesi Komuna është dashur me i plotësuar. Ministria e Arsimit nuk e ka futur në listën buxhetore, dhe ne si Komunë kemi qenë të obliguar të ndajmë mjete financiare për punën shtesë.

z.Besnik Seferi; Ky raport pasqyron gjendjen buxhetore. Të gjeturat janë si rezultate i qeverisjes së kaluar. Sa i përket çështjes të respektimit të afatit ligjore kjo është e papranueshme, dhe kjo nuk duhet të përsërit nga z.Aliu. Tenderët në Komunën e Shtimes nuk kanë qenë të specifikuar.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare e ZKF; Për pagesat që janë vonuar kemi pas gjendjen e pandemisë. Ne i kemi përsërit pagesën e këtyre pesë frakturave prandaj edhe i kemi marrë vërejtje.

z.Rrahman Jakupi; E falënderojë ZKF-në, opinioni i auditorit është i pamodifikuar, për shkak të Naim Ismajlit. Në mesin e pesë opinioneve, opinioni i pamodifikuar është me notën më të lartë pesë.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Është raport i mirë, por kemi edhe vërejtje. Edhe ne duhet me u marrë me këto vërejtje.

z.Besnik Seferi; Qysh e vlerësoni një marrëveshje për shërbime të veçanta?

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Dha sqarim.

z.Rrahman Jakupi; E kuptojë Bujar Feratin që nuk mundet me thënë 5 për shkak se Kryetari është këtu.

Kryetari z.Qemajl Aliu; Ju dëgjova të gjithëve me vëmendje, pika më e ndjeshme është kjo sepse ai që donë me punua ndershëm pasqyrohet pikërisht në këtë pikë. Në këtë raport i kemi mbi 15 të gjitura të cilat janë bukur shumë të rënda, janë shkelje që qeverisja e kaluar e ka dëmtuar buxhetin me qindra herë po ashtu edhe pronën publike. Te këto gjetje duhet me pas edhe vëmendjen e prokurorisë. Këtu është bërë keqpërdorim dhe kjo ka ndodhë për 20 vite radhazi, prandaj edhe mendojë se nevojitet vëmendja e prokurorisë sepse ka shkelje flagrante klasike. Është e çuditshme se si asnjeri anëtarë nga opozita nuk përmendi asnjë për këto të gjitura, por mundohen në mënyrë tinëzare ta kalojnë këtë raport me notën pesë nga kryetari i PDK-së.

z.Rrahman Jakupi; Kam përshtypjen që uji ta ka hyrë nën këmbë dhe ti nuk po e kupton. I inkurajojë prokurorët. Mendojë se kur të kanë dëgjuar auditorët kanë kesh me ty. Ti po e bën rolin e prokurorit. Ka këtu në Kosovë demokraci. Këtu i kemi 5 nënshkrime dhe këta janë profesionistë. Nuk e ki rolin e hetuesit, je Kryetar dhe bëje punën tende.

Kryetari z.Qemajl Aliu; Është e vërtetë që ju ka kapur sikleti, por nuk kam se çka ju bëjë, sepse ky është halli i qytetarit të Komunës së Shtimes. E kaluara është e juaja, që e keni të shkruar të zezen në të bardhë.

znj.Adelina Begaj; Ne jemi krenar për të kaluarën tonë. Unë nuk të dëgjova asnjëherë që thave se do të jemi transparentë pse nuk po e përmend transparencën.

Kryetari z.Qemajl Aliu; Është vërtet që Komuna ka qenë jo transparente, e pranojë që ka qenë në vendin e 22-të dhe tanjë jemi ne vendin e 27 pse, sepse në zyrën që duhet ta bëjë transparencën e kemi gjete vetëm një zyrtarë jo të përhershëm ndërsa në zyrën e prokurimit i kemi gjete 5-6 zyrtarë.

z.Përparim Ramusaj; Ne opozita nuk mundemi me i kuptuar paranojat e Kryetarit. Me atë zyrtarë dhe me shumë të tjera që sillen rrëth zyrës të Kryetarit ke dalë edhe më keq.

Kryetari z.Qemajl Aliu; Fakti që unë e kam nënshkruar një dokument për shpenzime, juve nuk ju amnistoni. Kryetari i PDK-së mua ma solli një dokument për me nënshkruar për dorëheqje, unë i kam kërkuar që të më sjellë fillimi i dokumentin që ke qenë i punësuar, sepse unë nuk kam asnjë dokument që ky ka qenë i punësuar.

z.Rrahman Jakupi; Drejtori i Arsimit të ka qitë në lajthitje edhe për mua edhe për të tjerët. Unë në vitin 2009 kam qenë zyrtarë për informim.

z.Lumni Amrushi; Ai (Kryetari) është këtu veç si mysafirë. Nuk po dihet a është Kryetarë a në pozitë. Vazhdoni e punoni, mos na akuzoni për gjërat që nuk janë.

#### Pika 6

#### Raporti Vjetor nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJB)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se me filluar me këtë pikë unë po jap 10 minuta pauzë, në ora 15:48. Vazhdimi i mbledhjes në ora 16:05.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtarë Kryesor finansiar; Materialin e keni marr me kohë dhe e keni lexuar. Po e paraqes në fjalë të shkurtta këtë raport (shih dokumentin). Ky raport i adresohet Kryetarit të Komunës, dhe kemi marr veprimet konkrete për zbatimin e tyre.

z.Përparim Ramusaj; Auditimi i brendshëm është ai që i jep llogari Kryetarit, nuk kam çka me diskutuar.

#### Pika 7

##### Zgjedhja e Komisionit për Ndryshimin e Rregullores për bashkëpunimin e komunës me fshatrat dhe lagjet urbane Npi – 01/89 datë: 27.03.2015

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ne realisht kemi një rregullore për zgjedhjen bashkësive lokale, por kemi edhe një Udhëzim Administrativ

I viti 2019 ka bere disa ndryshime, prandaj ne kemi par të arsyeshme ta themelojmë një komisionin që ta bëjmë një rregullore të re. Unë kam punuar me disa kryesues të Obiliqit dhe Lipjanit mos ti përmendi të gjithë me emra, një draft të rregullores që nuk dallon prej drafti që e ka pasur Komuna në vitin 2015. Por për arsyjeje të Udhëzimit Administrativ 02/2019 duhet te bëjmë disa ndryshime, por me gjithat kam menduar në bazë të konsultimeve që kam pasur me Komunat e tjera të bëjmë një Komision. Komisioni kam menduar te jetë i njëjtë për arsyjeje të numrit të banoreve të Shtimes, të ketë përbërje prej 5 anëtarëve: dy të janë nga Kuvendi, një nga pozita dhe një nga opozita, një nga shoqëria civile dhe një nga Ekzekutivi, por edhe një është nga fshatrat që duhet të zgjidhët. Kështu që ne si Kuvend e kemi për obligim si pozitë dhe opozitë të votojmë ata dy emra, e pastaj Ekzekutivi, edhe shoqëria civile të na sjellin një emër.

z.Përparim Ramusaj; Pajtohna me ndryshimin e rregullores, ne si opozitë e propozojmë Hamz Tërschanin.

znj.Shkurte Mustafa: Në emër të LVV-së, e propozojmë Besnik Seferin.

z.Reshat Mujota: Unë nuk kam propozim, prandaj në pjesën e Komisionit përfshihet edhe ato fshatra që janë të ndara si p.sh. Mollopolci, njashtu kemi edhe Godancin e Eperm dhe te Poshtëm, te jetë pra si anëtar i Komisionit Add hok edhe një përfaqësues i këtyre fshatrave.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi, nga 5 gjithësej, për Ndryshimin e Rregullores për bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat dhe Lagjet Urbane, Npi – 01/89 datë: 27.03.2015, si vijon:

1. z.Besnik Seferi.....(Përfaqësues nga pozita)
2. z.Hamëz Tërshani.....(Përfaqësuese nga opozita)

#### Pika 8

##### Informatë nga DKA për përgatitjet e fillimit te Vtit të ri shkollor

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Lulzim Sahiti.

z.Lulzim Sahiti, DKA; Përshëndetje informatën e kemi bërë në formë të shkruar dhe ne kemi dërguar me kohë dhe po besoj që e keni lexua. Unë do të ndalem te pikat kryesore (shih dokumentin). Në vazhdim drejtori lexoi informatën. Nëse ka ndonjë pyetje unë jam këtu për tu përgjigjur.

z.Reshat Mujota: Kam analizuar informatën dhe është shumë e komplektuar. Nesër është 1 shtatori (fillimi i viti të ri shkollorë). Kam tri pyetje: 1.Sa për qind janë bërë përgatitjet dhe cilat janë sfidat? 2.Dinamika e punëve te disa shkolla? 3.Si është furnizimi me lëndë djegëse? 4. A keni ndërmarrë diçka për transportin e nxënësve te lagja Ademaj dhe te Lagja e Azemhajdarve në Mollopolc.

z.Muhamed Ademaj; Faleminderit për informatën, dhe për punën e mirë që keni bërë, lajm i mirë është për që është siguruar uji për pije për shkollën Profesionale dhe shkollën në Petrovë.

z.Rahman Jakupi; Po e levojë në fund të informatës pse nuk është bërë dezinfektimi i shkollave, edhe pse nuk ka material higjenik.

**z.Rexhep Gashi;** Faleminderit për informatën po e pyes drejtorin te shkolla Lasgush Poradeci që ka ndodhë që është në gjendje të mjerueshme. Te shkolla Naim Frashëri a janë marrë masa, sepse u dashi me marrë masa?

**z.Rrahmani Jakupi;** Te faqë dy e informatës drejtor a keni diçka me shtuar rreth punës së drejtoreve?  
**z.Lulzim Sahiti, DKA;** Muhamet Ademaj, të gjitha shkollat janë furnizuar me tekste mësimore. Te Gjimnazi dhe të shkolla filllore Emin Duraku”, punë kryesi i ka vonuar punët edhe pse ne u kemi thënë disa herë. Për lëndët djegëse mund të ju japi informata më të detajuara pak më vonë. Sa i përket transportit të nxënësve e kemi përfunduar në fshatin Pjetershticë, po flasim për bugjetin e viti 2022. Sa i përket aktivitetave sindikale ata i kanë punët e veta. Sa i përket DZD-së është bërë në 7 shkolla, po ashtu e bëjëmë edhe aty ku ka nevojë. Te ditarët ka ndryshuar forma, tek sot unë kam informata se furnitorët kan me i pru. Mjetet higjenike deri tanë i kanë disa shkolla.

**z.Rexhep Gashi;** Te shkolla “Naim Frashëri” e kemi notën mesatare 2.7, çfarë masa keni marr për përmirësimin e notës mesatare?

**z.Lulzim Sahiti, DKA;** Është e vërtet se në bazë të suksesit të nxënësve edhe janë regjistruar ne Gjimnaz.

**znj.Adelina Beqaj:** A je i informuar që testi i maturës nuk është bërë për shkak të mungesës së materialit?

**z.Lulzim Sahiti, DKA;** Sa i për ketë testit të maturës krejt 12 nxënës nuk e kanë mundur me ju nënshtuar testit të maturës për shkak të testeve që munguan.

**z.Reshat Mujota;** Drejtori i dha përgjigjet. Viti i ri shkollor po fillon ndërsa gjendja në teren është kështu: (E tregon telefonin). Te çerdhja e ke dërguar bashkëshorten si praktikante, ma mirë dërgoje me një herë në punë, sepse ndoshta jeni mësuar si në të kaluarën, që një herë me dërguar si praktikante e pastaj me punësuar.

**z.Lulzim Sahiti, DKA;** Sqaroi se sa i për ketë bashkëshortes ajo ka shkuar te Çerdhja por jo me dëshirën e sajë por për arsyje se e ka për obligim për me i krye orët praktike, e nuk ka të bëjë fare me çështjen e punësimit.

**z.Hamëz Tërshani;** Te shkolla e mesme dhe ajo filllore në Shtime, a është e vërtetë që është neglizhencë e juaja për sa i përket efiqencës që keni dashur me u tërheq?

**z.Lulzim Sahiti, DKA;** Kjo nuk varet aspak nga ne por nga punë kryesi, ne jo që ja kemi refuzuar këtë por ne kemi kërkuar një gjë të tillë.

#### Pika 9

##### Propozim-Vendim për emërtimin e Shkollës Profesionale sipas Vendimit të MASHT-it Nr.2-3726 dt.28.08.2019 “Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional”

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Lulzim Sahiti.

**z.Lulzim Sahiti, DKA;** Sqaroi se është ë nevojshme një ndryshim i tillë të emërtimit të shkollës Profesionale mbi bazën e U.A, sipas Vendimit të MASHT-it Nr.2-3726 dt.28.08.2019, duke ndryshuar emërtimin nga “Shkolla Profesionale” në emërtimin e ri “Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional”.

**z.Rexhep Gashi;** Cka nëse nuk e voton Kuvendi.

**z.Lulzim Sahiti, DKA;** Ministria tregon vetëm se si duhet të emërohet kjo shkollë, ndërsa vendimin e merr Kuvendi dhe është punë e tijë se si vendosë.

**z.Muhamet Ademaj;** Unë e përkrahu këtë vendim për ndryshimin e emrit të “Shkollës Profesionale”. Mendoj se në këtë shkollë do të hapen edhe dy paralele.

**z.Përparim Ramusaj;** Pajtohem për ndryshmin e emrit të kësaj shkolle dhe do ta votojmë.

\*Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për ndërrimin e emrit të Shkollës Profesionale në Shtime me emrin “Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional”.

Pika 10 (Pikë shtesë)

Propozim për ndryshimin e nenit 3.5 të Rregullores së Punës së Kuvendit Npi-01-114 të datës

26.4.2019

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Rahman Jakupi;** Propozojë që pika 3.5 e rregullores së punës së Kuvendit të ndryshohet.

**z.Përparim Ramusaj;** Nuk po shohë që ka nevojë që të bëhet debat për këtë pikë. Propozojë që pika 3.5 e rregullores të punës së Kuvendit të ndryshojë dhe të bëhet kështu: "Anëtarët e Kuvendit mundë të marrin pjesë në mbledhje on-line ata që janë të sëmur me Kovid 19, dhe ta prezantojnë testin e Kovid 19".

**z.Besnik Seferi;** Plotësisht pajtohem që të bëhet ndryshimi i rregullores të punës të Kuvendit por jo vetëm për pikën 3.5. unë mendoj se nuk është momentumi që të bëhet ndryshimi i vetëm një nen, sepse kjo rregullore ka nevojë që të ndryshohet bukur shumë.

**z.Reshat Mujota;** Po mundohem me e kuptuar secilin asamblistë. Besniku siç e patë "Absteno" ndërkaq që unë jam "Për" që të ndryshohet vetëm kjo pikë e rregullores.

**z.Besnik Seferi;** Unë nuk jam kundër ndryshimit të rregullores por jo sot edhe jo vetëm pika 3.5.

**z.Reshat Mujota;** Unë nuk e mora tragjike sepse ai është goxha i drejtë. E kam një pyetje a keni ju shef të VV-së.

**z.Përparim Ramusaj;** Unë gjithë kolegët i respektoj, sepse kanë vota. Unë mendoj se në këtë formë vetëm sa ja humbim vlerën Kuvendit. Ka qenë situata tjetër d.m.th ka qenë gjendje e pandemisë kur Kuvendi e ka aprovuar këtë. Ne po themi që ata që infektohen me Kovid të kanë të drejtë me qenë pjesë ë mbledhjes on-line.

**znj.Adelina Beqaj;** Unë po të kuptoj si Adnan, por nuk po me duket e hijshme që asamblistja në fjalë vec me e ngrit dorën, on-line. Dihet që me 3 mungesa të pa arsyeshme hiqet nga lista.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë mendoj që është diskriminim, sepse çdo femre mundet me i ndodh diçka e tillë, p.sh si të veprohet me rastet e shtatzënise ose raste të tjera që mund të ndodhin prandaj po them që është diskriminim.

**z.Rexhep Gashi;** Unë fillimisht e kërkova formimin e Komisionit, e që nuk kaloj, ku edhe ti ishe "Kundër". Kjo pikë shtesë ka kaluar edhe me votën tënde, tanë tregona a je për ndryshim a jo?

**z.Reshat Mujota;** Hedhe në votim propozimin, sepse po të kishte qenë dikush tjetër nuk e kishe kyçur on-line.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ti vetëm bëje kërkesën, ta garantojë se ki me u kyçur on-line.

**z.Hamëz Tërshani;** Unë jam për me hedh në votim. Ne mundemi me shkuar në pushime di kund me u kyçur ne mbledhje online.

**z.Muhamet Ademaj;** Ndoshta ka arsyje që Heroina nuk po merr pjesë ne mbledhje. Unë mendojë që ne muajin shtator do ta trajtojmë këtë propozim për ndryshim.


**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

\***Kuvendi i Komunës me 10 vota "Për" me 9 vota "Kundër" dhe 0 vota "Abstenim" miratoi ndryshimin e nenit 3.5 të Rregullores së Punës të Kuvendi dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019 si vijon:**

Neni 3.5 i Rregullores të Punës së Kuvendi dhe Komiteteve me numër Npi – 01/114 e datës: 26.4.2019 në të cilin thuhet "Kuvendi, Komitetet dhe Trupat tjerë të Kuvendit mund të organizojnë mbledhje nga distanca (on-line) në kushte të veçanta". Ndryshohet dhe bëhet si vijon: "Kuvendi, Komitetet dhe Trupat tjerë të Kuvendit mund të organizojnë mbledhje nga distanca (on-line) vetëm në rastet kur anëtarë është i sëmurë me Kovid19. (dëshmi testi Kovid)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoj në ora 17:21h.


Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi





Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi



Faqe 15 nga 15